



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Rruga Rruga "Abdi Toptani" Nr. 1 Tiranë.

E-mail: klsh.org.al; [ëeb-site ëë.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)

Nr. 1153/6 Prot.

Tiranë, më 17.12.2018

V E N D I M
Nr.204, Datë 17.12.2018

PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR NË KËSHILLIN E QARKUT SHKODËR ME OBJEKT
“FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIE”
për periudhën nga data 01.06.2016 deri më datën 30.09.2018

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit, përpjekjet pozitivisht të vlerësuara dhe gatishmërinë në mundësimin e përmbushjes së afateve të dorëzimit të dokumentacionit nga ana e Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, në mbështetje të nenit 10, 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit me objekt: “*Auditim financiar dhe përputhshmërie*” të ushtruar në Këshillin e Qarkut Shkodër, sipas programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH nr. 1153/1, prot., datë 12.10.2018, për veprimtarinë ekonomiko-financiare nga data 01.06.2016 deri më datën 30.09.2018.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITUESIT:

Opinionin i pakualifikuar mbi pasqyrat financiare¹

¹ Një opinion i pakualifikuar jepet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se: pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi; janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse; situata e paraqitur nga pasqyrat financiare është në përputhje

Ne kemi kryer auditimin financiar mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 24.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit financiar të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit SSAI 1700 , dhe ISSAI 1200 , si dhe në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar tek pjesa, Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet buxhetore, KLSH është e pavarur nga Njësia e Qeverisjes Vendore Këshilli i Qarkut Shkodër dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin ushtrimor, më 31 dhjetor 2016 dhe më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e gjendjes ekonomike, pozicionit financiar (hyrjeve dhe daljeve të pagesave në para, pasqyra e amortizimit, pasqyrën e krahasimit të fondeve buxhetore dhe rezultateve aktuale, shënimet shpjeguese që shoqëronin këto pasqyra, kryerjen e inventarëve për çdo fund viti. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Duke marrë në konsideratë faktin se subjekti audituar mund të mos arrijë në kuptimin e saktë të opinionit mbi pasqyrat financiare, duam të tërheqim vëmendjen për çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave, që nuk kanë ndikim të dukshëm mbi nivelin e materialitetit dhe në vendimmarrjen e përdorueseve të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit të KLSH-së, mbështetur në standardet ISSAI 1700², dhe ISSAI 1200³, pasqyrat financiare të konsoliduara nuk paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Këshillit të Qarkut Shkodër në datën 31 dhjetor 2017 në llogaritë vjetore”.

Opinionit i auditimit:

Sipas opinionit të KLSH-së, mbështetur në standardet e mësipërme, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet material, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Këshillit të Qarkut Shkodër në datën 31 dhjetor 2017 për të cilën japim opinionin të pakualifikuar.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të Këshillit të Qarkut Shkodër paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Këshillit të Qarkut Shkodër në datën 31.12.2017 dhe rezultatet e operacioneve të tyre dhe të flukseve monetare për vitin e përfunduar, në përputhje me Kuadrin e Raportimit Financiar të Sektorit Publik si dhe bazën

me njohuritë e audituesit mbi njësinë publike të audituar; dhe janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare

² Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

³ Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi

ligjore që rregullon raportimin financiar dhe atë buxhetor.

Ne kemi kryer auditivin në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditivit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë të detajuar në paragrafin “ Përgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare” të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e theksuar nga ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditivin e pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditivit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Këshillit të Qarkut Shkodër

Nëpunësi Autorizues dhe nëpunësi zbatues të Këshillit të Qarkut Shkodër janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshime dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar I nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Staf i drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave në taksat e tarifave vendore.

Përgjegjësitë e Audituesve Shtetëror të KLSH-së mbi auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH-së gjithashtu aplikon gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun, ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë

B. MASA ORGANIZATIVE

1-Gjetje nga auditimi: Këshilli i Qarkut Shkodër ka implementuar kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe ka vënë në zbatim Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Subjekti ka hartuar raportin për funksionin e sistemit të kontrollit të brendshëm, deklaratën për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm si dhe pyetësoresin e vetëvlerësimit. Por nga ana e Këshillit të Qarkut Shkodër nuk është hartuar dhe miratuar dokumentacioni në lidhje me planifikimin e

objektivave dhe planeve strategjike e vjetore si dhe e zbatimi i tyre, ku përfshihen strategjia e menaxhimit të riskut, harta e proceseve ku duhet të specifikohet qarkullimi i dokumentave. Gjithashtu nuk është miratuar dokumenti i gjurmës së auditimit, kodi i etikës profesionale për nivelin menaxhues dhe për punonjësit e tjerë si dhe nuk janë përditësuar kontrollat që synojnë minimizimin e riskut, Këto veprime bien në kundërshtim me nenet 6, 20, 21, 22 dhe 23 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe nenin 66, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (Më hollësisht trajtuar në pikën II.A Menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm, në faqet 6-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1-Rekomandim: Nëpunësi Autorizues dhe zbatues të Këshillit të Qarkut Shkodër, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e evidencave dokumentare të planifikimit të objektivave dhe planeve strategjike e vjetore dhe të zbatimit të tyre, ku të përfshihen strategjia e menaxhimit të riskut, harta e proceseve, gjurmët e auditimit dhe kodi i etikës profesionale për nivelin menaxhues dhe për punonjësit e tjerë të institucionit.

Menjëherë

2-Gjetje nga auditimi: Në Këshillin e Qarkut Shkodër bazuar në evidencat dhe bilancet kontabile deri në datë 30.09.2018 rezultojnë debitorë 32 subjekte dhe persona, në vlerën 4,281,842 lekë të krijuar nga viti 1993 nga të cilët 23 subjekte dhe persona, në vlerë 2,564,605 lekë janë detyrime të lëna në auditimet e KLSH pa arkëtuar asnjë vlerë. (Trajtuar më hollësisht në faqet 19-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1- Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Shkodër, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik të marrë masa për parashikimin e shpenzimeve në nivele të realizueshme për pagesën e faturave të pa likuiduara në vlerën totale **2,564,605 lekë**, bazuar në UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” dhe Udhëzimin Plotësues nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91-*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*, dhe të paraqesë në mbledhjen e Këshillit të Qarkut, material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite shoqëruar me grafikun për shlyerjen e detyrimeve.

Menjëherë

3.-Gjetje nga auditimi:

a) Ish- Inspektorati Ndërtimor Urbanistik i Këshillit të Qarkut Shkodër, nuk ka arkëtuar gjomat për shkeljet e konstatuara në 7 ndërtimet pa leje ndërtimi, si dhe nuk ka ndjekur në rrugë ligjore me padi në gjykatë për 7 vendime në vlerën 1,717,237 lekë, që përbëjnë të ardhura të munguara të paplanifikuara në buxhetin e Qarkut, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” nenet 20, 30 dhe ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar (Trajtuar hollësisht në faqet 19-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

b. Konstatohet se vendimet e gjobave të INUV nuk janë dërguar në gjykatë për kthimin në tituj ekzekutiv dhe nuk janë llogaritur kamatëvonesa në masën 60% të vlerës dhe për pasojë kundërvajtësit nuk janë ngarkuar me kamat vonesa në kundërshtim me:

a-nenin 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, me ndryshime, përcaktohet se: -Gjoba paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afat paguhet kamatë 2 për qind për çdo ditë vonesë, deri në një muaj. Kur edhe pas këtij afati nuk kryhet pagesa, vendimi ekzekutohet në rrugë gjyqësore sipas ligjit.

-Neni 15-(Ndryshuar dy fjalitë e para me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007, neni (Ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007, neni 2) (Shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr. 10324, datë 23.9.2010, neni 3) (Trajtuar më hollësisht në faqet 19-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1-Rekomandim: Këshilli i Qarkut Shkodër, Drejtoria Juridike të marrë masat dhe të kërkojë në Gjykatë rivendosjen në afat të 7 Vendimeve të gjobave të vendosura në vitin 2014 nga ish INUV i Këshillit Qarkut Shkodër për ndërtimet e pa ligjshme, në vlerën **1,717,237 lekë**, bazuar në nenet 151 dhe 152, të “Kodit Procedurës Civile në RSH”. Njëherazi të marrë masa për llogaritjen e kamat vonesave dhe kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv në zbatim të nenit 24-Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”

Menjëherë

4- Gjetje nga auditimi: Buxheti i Këshillit të Qarkut Shkodër është përqendruar vetëm në realizimin e shpenzimeve korrente, ndërsa nuk është gjithë përfshirës sepse fondet për përmirësimin e infrastrukturës së rrugëve rurale, financimin e projekteve dhe studime e projektme për investime veçanërisht për njësitë e qeverisjes vendore me burime të pakta, të ardhurash janë në nivel të ulët, për pasojë nëpërmjet buxhetimit Këshilli i Qarkut nuk ka arritur objektivat për pjesëmarrje me financim të projekteve dhe studime për projektme, veprim në mospërputhje me procedurat e UMF nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” pika 121, pasi nuk janë mbajtur akt-marrëveshje për detyrimin vjetor të NJQV ndaj KQ, nuk janë bërë përpjekje për transferimin e këtyre kuotave nga NJQV në favor të KQ. Plan buxheti përfundimtar është miratuar nga KQ Shkodër jashtë afateve ligjore, por si pasojë mos alokimit të fondeve të planifikuara nga qeverisja qendrore dhe nga mosderdhja e kuotave të qeverisjes vendore për shkak të reformës administrativo-territoriale, ka sjellë **të ardhura të munguara në buxhetin e Këshillit të Qarkut në vlerën totale 8,907 mijë lekë**, si pasojë e formalizmit në programimin e tregueseve të buxhetit dhe burimeve të financimit, në mospërputhje me neni 32 “Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vendor”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”. (Trajtuar më hollësisht në faqet 12-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1-Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Shkodër të marrë masa që programimi dhe buxhetimi në planin financiar të vitit raportues të jetë gjithëpërfshirës, krahas projekteve të zhvillimit prioritet t’i jepet realizimit të të ardhurave nga zbatimi i kuotave të anëtarësisë së Njesisë së Qeverisjes Vendore.

Menjëherë

5-Gjetje nga auditimi: Prokurimi për punimet e ndërtimit në objektet:

a. Rehabilitim varrezat e Dëshmorëve Pukë, me fond limit 3,332,666 lekë pa TVSH, tenderi zhvilluar në datën 12.03.2018 dhe lidhur kontrata e punimeve në datë 10.04.2018 me sipërmarrësin “N”, në vlerën 2,413,635 lekë pa TVSH,

b. Rikonstruksion shkolla “Edit Durham” me fond limit 2,499,795 lekë pa TVSH, tenderi zhvilluar në datë 07.03.2018 dhe lidhur kontrata e punimeve në datë 13.04.2018 me sipërmarrës bashkimin e operatorëve “R 94” & “K.G.K” me vlerën 1,863,451 lekë pa TVSH,

c. Sistemim – Asfaltim rruga Shkolla Bardhaj- Qaf Rrenc me fond limit 25,173,333 lekë pa TVSH, tenderi zhvilluar në 18.06.2018 dhe lidhur kontrata e punimeve nr.698, datë 14.08.2018 me sipërmarrësin “A.T”, në vlerën **24,532,171 lekë pa TVSH** janë

zbatuar në mungesë të lejes së ndërtimit. Këshilli i Qarkut Shkodër nuk ka aplikuar për leje ndërtimi dhe ka prokuruar zbatimin e këtyre punimeve në mungesë të lejes së ndërtimit. Mungesa e lejes së ndërtimit të objektit është në kundërshtim me nenin 39 të ligjit nr.107, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar.(Trajtuar më hollësisht në faqet 45-56 Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligj.

5.1- Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Shkodër për të gjitha projektet, të cilat sipas ligjit të sipërcituar duhet të pajisen me leje ndërtimi, të aplikojë për leje pranë bashkive përkatëse apo Këshillit Kombëtar të Territorit, sipas rastit, para se të nisë procedurën e prokurimit të punimeve.

Në vijimësi

6.- Gjetje nga auditimi: Nga rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm të KLSH (me datën 12.07.2011) për shpërblim dëmi nga 7 (shtatë) punonjës në vlerën 198,398 lekë deri më datë 30.09.2018 është arkëtuar vlera 70,000 lekë duke mbetur në proces arkëtimi vlera 128,398 lekë.(Trajtuar më hollësisht në faqet 19-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1- Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik pranë Këshillit të Qarkut Shkodër, të rikërkojë përsheptimin e likuidimit të detyrimeve debitore të 7 (shtatë) punonjësve në vlerën 128,398 lekë duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore.

Në vijimësi

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim, ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R